

SALTO-YOUTH
SOUTH EAST EUROPE
RESOURCE CENTRE



Erasmus+

ERASMUS+: YOUTH IN ACTION

Erasmus+

salto|youth



MUNDËSITË PËR RAJONIN E BALLKANIT PERËNDIMOR

Ky publikim është një përmbledhje e mundësive të ofruara nga programi Erasmus+ i Komisionit Evropian, në veçanti për aplikantët potencial dhe përfituesit, në të ashtuquajturat vendet partnere të programit në Ballkanin Perëndimor¹, të cilat mund të marrin pjesë në program sipas kushteve specifike.

E gjithë përmbajtja e këtij publikimi prezantohet me synimin për të dhënë një pasqyrim fillestar në programin Erasmus+. Para se të vendosin të paraqesin një projekt propozim për mbështetje financiare nga ky Program, aplikantët sugjerohen të lexojnë Guidën e Programit të vitit përkatës, e cila paraqet në detaje kushtet dhe kriteret për financim, si dhe detyrimet ndaj përfituesve.

Gjithashtu, rekomandohet që organizatat në rajonin e Ballkanit Perëndimor, të kërkojnë këshilla dhe udhëzime, apo të ndjekin faqet zyrtare dhe kanalet e ndryshme të komunikimit të Agjensisë Ekzekutive për Edukim, Audio-vizualitet dhe Kulturë të Komisionit Evropian (European Commission's Education, Audio-visual and Culture Executive Agency - EACEA), Qendrës Burimore e Ballkanit Perëndimor SALTO SEE apo nga Pikat Kombëtare të Kontaktit në Ballkanin Perëndimor, para afateve të aplikimit. Adresat e kontaktit mund ti gjeni në fund të këtij publikimi nën pikën (më shumë informacion).

¹ Ky përcaktim është pa paragjykimet ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe Opinionin e GJDNJ mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

PROGRAMI ERASMUS+

Erasmus+ është Program i Bashkimit Evropian në fushën e edukimit, trajnimit të të rinjve dhe sportit deri në vitin 2020. Është i ndërtuar në traditën 25 vjeçare të programeve Evropiane në fushat përkatëse, me një komponent më shumë siç është mbështetja për sportet.

Programi adreson sfidat bashkëkohore socio-ekonomike në Evropë duke forcuar sistemet e arsimit dhe aftësimit, punën me të rinjtë dhe politikat rinore dhe duke nxitur të mësuarit gjatë gjithë jetës. Edukimi, aftësimi, puna me të rinjtë dhe sportet janë çelësi për të promovuar vlerat e përbashkëta Evropiane; për të nxitur integritimin social, përfshirjen e individëve me disavantazhe, mirëkuptimin ndërkulturor dhe parandalimin e radikalizimit të dhunshëm. Programi ka si qëllim t'u japë të rinjve aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për tregun e punës dhe ekonominë; ndërkohë që i nxit ata të jenë pjesë aktive e shoqërisë si dhe të realizojnë potencialin e tyre personal.

Implementimi i Programit ndjek këto objektiva të përgjithshme:

- Objektivat e Strategjisë së Evropës 2020, duke përfshirë edhe objektivin kryesor të arsimit²;
- Objektivat e kornizës strategjike për bashkëpunim Evropian në arsim dhe trajnim (ET 2020), duke përfshirë edhe standardet përkatëse;
- Zhvillimin e qëndrueshëm të vendeve partnere në fushën e arsimit të lartë;
- Objektivat e përgjithshme të kornizës së rinovuar të bashkëpunimit Evropian në fushën e të rinjve (2010 - 2018);
- Objektivin e zhvillimit të dimensionit Evropian në sport, në veçanti atë të sporteve baze, në përputhje me planin e punës së BE-së për sportin;
- Promovimi i vlerave Evropiane në përputhje me Nenin 2 të Traktatit të Bashkimit Evropian³; (Burimi: Guida e Programit 2018)

Objektivat e përgjithshme të programit plotësohen me objektiva specifike për secilin nga kapitujt e tij.

PROGRAMI ËSHTË I NDARË NË TRE FUSHA TË MËDHA:

Fusha e edukimit dhe trajnimit ofron mundësi për **sektorin e arsimit** para-universitar, **sektorin e arsimit dhe edukimit profesional**, **sektorin e arsimit nëntëvjeçar dhe sektorin e edukimit të të rriturve**, ndërkohë që **Jean Monnet** ofron mbështetje të studimeve Evropiane, nëpërmjet mbështetjes së institucioneve arsimore.

Fusha e të rinjve ofron mundësi për **sektorin e të rinjve**.

Fusha e **sportit** është e fokusuar në sektorin e sportit dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në projekte dhe aktivitete.

² Objektivi kryesor i arsimit është zvogëlimi i braktisjes së shkollës së hershme në më pak se 10% dhe rritja e arritjeve në arsimin 9 vjeçar në të paktën 40% deri në vitin 2020.

³ Bashkimi bazohet në vlerat e respektit për dinjitetin njerëzor, lirinë, demokracinë, barazinë, sundimin e lirisë dhe respektimin e të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e personave që i përkasin pakicave. Këto vlera janë të përbashkëta për Shtetet Anëtare në një shoqëri në të cilën mbizotëron pluralizmi, mosdiskriminimi, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia gjinore.

⁴ Është përdorur ermi i gjendur në Guidën e Programit me qëllim që lexuesi të jetë më i qartë gjatë marrjes së informacioneve në gjuhën Angleze.

MUNDËSITË PËR MBËSHTETJE BRENDË PROGRAMIT JANË TË NDARA NË TRE KEY ACTIONS:

Key Action 1: Lëvizja e individëve

KA1 i dedikohet në mënyrë të veçantë lëvizjes ndërkombëtare të të nxëniet të individëve ose grupeve, ku qëllimi kryesor i bashkëpunimit është nxitja e të mësuarit tek pjesëmarrësit.

Key Action 2: Bashkëpunimi për inovacionin dhe shkëmbimi i praktikave të mira

KA2 i dedikohet bashkëpunimit strategjik afatgjatë të partnerëve nga shtete të ndryshme, duke synuar inovacionin, rezultatet e qëndrueshme dhe zhvillimin e përgjithshëm të strukturave dhe politikave në fushën e edukimit, trajnimit dhe rinisë në Evropë.

Aksioni i Veprimit 3: Mbështetja për reformat politike

KA3 ka si qëllim të mbështesë reformat politike në fushat e edukimit, trajnimit dhe rinisë në Evropë, në veçanti për përmbushjen e qëllimeve të Strategjisë së Evropës 2020, të Kornizës Strategjike për bashkëpunim Evropian në Arsim dhe Trajnim (ET 2020), si dhe të Strategjisë Evropiane të Rinisë.





ERASMUS+: YOUTH IN ACTION

Aktivitetet në kuadër të Programit që targetojnë fushën e rinisë njihen përmes termit Erasmus+: Youth in Action, të cilat ofrojnë mundësi të ndryshme bashkëpunimi për të rinjtë, për punonjësit rinor dhe politikë-bërësit e rinj. Gjithashtu ofrojnë përfitimin e aftësive dhe të qenit pro-aktiv në ndërtimin e një shoqërie Evropiane të qëndrueshme dhe demokratike. Përveç objektivave të përbashkëta të Programit në tërësi, Erasmus+: Youth in Action funksionon si një instrument i rëndësishëm për të vënë në praktikë Strategjinë Rinore të Bashkimit Evropian 2010 - 2018, të përcaktuar në rezolutën e Këshillit të BE-së më 27 Nëntor 2009. Korniza përcakton tetë fusha prioritare të bashkëpunimit brenda BE-së dhe Shteteve Anëtare deri në vitin 2018.

Objektivat kryesore të këtij bashkëpunimi janë:

- të ofrojë mundësi më të shumta dhe të barabarta për të gjithë të rinjtë në arsim dhe në tregun e punës;
- të promovojë qytetarinë aktive, përfshirjen sociale dhe solidaritetin e të gjithë të rinjve.

Duke u bazuar në Strategjinë e Rinisë, objektivat specifike të mëposhtme ndiqen nga Programi Erasmus+ në fushën e rinisë:

- të përmirësojë nivelin e kompetencave dhe aftësive të të rinjve, duke përfshirë ato me më pak mundësi; si dhe të promovojë pjesëmarrjen në jetën demokratike në Evropë, në tregun e punës, qytetarisë aktive, dialogut ndërkulturor, përfshirjen sociale dhe solidaritetin; veçanërisht përmes rritjes së mundësive të lëvizjes së të rinjve, të atyre aktivë në punën me të rinjtë apo organizatave rinore dhe liderave të rinj, si dhe të forcojë marrëdhëniet mes fushës rinore dhe tregut të punës;
- të nxisë përmirësimin e cilësisë së punës me të rinjtë, në veçanti nëpërmjet bashkëpunimit të rritur mes organizatave në fushën e rinisë dhe/ose palëve të tjera të interesit;
- të plotësojë reformat politike në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar; të mbështesë zhvillimin e njohurive dhe politikave rinore të bazuara në fakte, si dhe njohjen e edukimit jo-formal dhe mësimor informal, veçanërisht përmes rritjes së bashkëpunimit politik, përdorimit më të mirë të mjeteve të transparencës dhe njohjes së BE-së dhe përhapjen e praktikave më të mira;
- të përmirësojë dimensionin ndërkombëtar të aktiviteteve rinore dhe të rrisë kapacitetin e punonjësve rinor dhe organizatave, në mbështetjen e tyre për të rinjtë si një mjet plotësues i aksioneve të jashtme të Bashkimit Evropian; veçanërisht përmes nxitjes së lëvizshmërisë dhe bashkëpunimit ndërmjet palëve të interesuara nga Vendet e Programit, Vendet Partnere dhe organizatat ndërkombëtare. (Burimi: Program Guide 2018)

ÇFARË ËSHTË MËSIMI JO - FORMAL?

Programi Erasmus+: Youth in Action u ofron të rinjve mundësi të ndryshme për marrjen e kompetencave dhe zhvillimin personal përmes mësimi jo-formal. Koncepti i referohet të mësuarit që zhvillohet jashtë programit mësimor formal dhe përfshin një qasje pjesëmarrëse, jo diskriminuese dhe të orientuar tek individ (ai që mëson). Mësimi jo-formal është vullnetar dhe për këtë arsye është i lidhur ngushtë me nevojat dhe interesat e të rinjve. Një edukim jo-formal cilësor që ofrohet nga përfituesit (organizatat që zbatojnë projekte) është një aspekt kyç i të gjitha projekteve të financuara në kuadër të Programit Erasmus+: Youth in Action.



AKTIVITETET E PROGRAMIT ERASMUS+: YOUTH IN ACTION

PROGRAMI ERASMUS+: YOUTH IN ACTION MBËSHTET AKTIVITETET E MËPOSHTME:

AKTIVITETET E LËVIZJES

në brendësi të Key Action 1 ose Key Action 2,
në veçanti:

- **Shkëmbimet Rinore** (më shumë informacion në faqet 10 – 11)
- **Aktivitetet Vullnetare** (më shumë informacion në faqet 12-13)
- **Lëvizja e punonjësve rinor** (më shumë informacion në faqet 14-15)


Një projekt mund të përfshijë një ose më shumë nga këto aktivitete të lëvizjes. Por, në KA1 një projekt mund të përfshijë Shëmbime Rinore dhe Lëvizjen e punonjësve rinor; ndërsa Aktivitetet Vullnetare duhet të aplikohen si projekte më vete, të cilat mund të përfshijnë “aktivitete plotësuese” (shiko faqen 12 për më shumë detaje).

PËR PARTNERITETET STRATEGJIKE DHE NGRITJEN E KAPACITETEVE NË FUSHËN E RINISË

në brendësi të Key Action 2 (gjeni më shumë informacion në faqet 16-19).

PËR TAKIMET NDËRMJET TË RINJVE DHE VENDIM-MARRËSVE NË FUSHËN E RINISË

në brendësi të Key Action 3 gjeni (më shumë informacion në faqet 20-21)



BASHKËPUNIMI ME BALLKANIN PERËNDIMOR NË ERASMUS+: YOUTH IN ACTION

Programi Erasmus + është gjithashtu i hapur për vendet partnere me Bashkimin Evropian (gjeni më shumë informacion për të gjitha vendet pjesëmarrëse në faqet 24-25).

Vendet partnere në rajonin e Ballkanit Perëndimor përfshijnë: Shqipërinë, Bosnjen dhe Hercegovinën, Kosovën⁵, Malin e Zi dhe Serbinë. Statusi i tyre si vende kandidatë apo vende potenciale për kandidatë në kuadër të politikës së zgjerimit të Bashkimit Evropian sugjeron perspektivën e anëtarësimit në të ardhmen. Në këtë kontekst, programi Erasmus+: Youth in Action, (i barabartë me paraardhësit e tij YOUTH 2000-2006 dhe Programi Youth in Action 2007-2013), funksionon si një instrument kyç për të lehtësuar procesin e integritetit në rajonin e Ballkanit Perëndimor në fushën e të rinjve. Disa nga këto vende mund t'i bashkohen Programit Erasmus + në vitet e ardhshme. Për tu informuar mbi statusin specifik të një shteti me informacion të përditësuar, konsultohuni me versionin më të fundit të Guidës së Programit.

⁵ Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe Opinionin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Organizatrat nga Vendet Partnere të Ballkanit Perëndimor mund të marrin pjesë në programin Erasmus+: Youth in Action si:

PARTNERË NË PROJEKTET E MËPOSHTME:

- **Shkëmbimet Rinore, Aktivitetet Vullnetare apo Lëvizja e punonjësve rinor** në projekte nën Key Action 1
- **Partneritetet strategjike në fushën e rinisë** në projekte nën Key Action 2 (sipas kushteve specifike)
- **Takime mes të rinjve dhe vendim-marrësve në fushën e rinisë** në projekte nën Key Action 3

(Do të gjeni më shumë informacion mbi këto aktivitete në faqet 10-17 dhe 20-21)

SI APLIKANTË PËR PROJEKTET E MËPOSHTME:

- **Ngritja e kapaciteteve në fushën e rinisë (Capacity Building in the Field of Youth)**, në veçanti në kontekstin e Dritares Rinore të Ballkanit Perëndimor, nën Key Action 2. Përveç aktiviteteve të ngritjes së kapaciteteve të cilat janë të domosdoshme në çdo projekt, projektet mund të përfshijnë dhe aktivitete të lëvizjes (Shkëmbime rinore, Aktivitete Vullnetare apo Lëvizja e punonjësve rinor) që korrespondojnë me aktivitetet e Key Action 1. (Më shumë informacion mund të gjeni në faqet 18-19).



Një shkëmbim rinor është një mjet efektiv i mësimi jo-formal dhe informal në punën me të rinjtë. Kjo lejon që grupet e të rinjve nga vende të ndryshme të kalojnë deri në 21 ditë së bashku, duke eksploruar tema të përbashkëta. Në këtë proces, të rinjtë zhvillojnë kompetencat e tyre, bëhen të vetëdijshëm për temat shoqërore aktuale apo fusha të ndryshme tematike, zbulojnë kultura dhe mënyra jetese të reja së bashku me bashkëmoshatarët e tyre nga vende të ndryshme, si dhe forcojnë vlera të tilla si solidariteti, barazia dhe demokracia.

Shkëmbimet rinore përbëhen nga disa faza: hartimi dhe planifikimi i aktivitetit, ndjekur nga zbatimi i tij; përfundimi dhe vlerësimi i aktivitetit, dhe në fund shpërndarja dhe shfrytëzimi i rezultateve. Detyrat praktike që të rinjtë pjesëmarrës ndërmarrin në të gjitha fazat e aktivitetit u ofrojnë atyre mundësi të ndryshme të të mësuarit, përmes të cilave marrin dhe kompetenca specifike. Vendosja e shkëmbimeve rinore në kontekstin e të mësuarit jo-formal kërkon që të paktën një pjesë e rezultateve të dëshiruara të të mësuarit të planifikohen paraprakisht, në mënyrë që të sigurojnë mundësitë e duhura. Përcaktimi i rezultateve të dëshiruara të të mësuarit, mund të fillojë në cilindo apo secilin nga grupet e të rinjve, duke identifikuar kompetencat që pjesëmarrësit dëshirojnë të marrin ose zhvillojnë nëpërmjet Shkëmbimit Rinor.

Çdo grup pjesëmarrës ka një lider, i/e cili/a ndihmon dhe mbështet pjesëmarrësit në zbatimin e aktivitetit. Duke qenë se menaxhimi i një aktiviteti të tillë kërkon marrjen e vendimeve të shumta, një Shkëmbim Rinor gjithashtu mund të shërbejë si një mundësi për të mësuar rreth pjesëmarrjes demokratike dhe proceseve të vendimmarrjes në shoqëri. Megjithatë, kjo mund të arrihet vetëm nëse sa më shumë nga këto vendime merren nga të rinjtë pjesëmarrës ku dhe mundësia për të marrë vendimet së bashku duhet gjithashtu të nënkuptojë marrjen e përgjegjësisë.

Në fazat e përfundimit dhe shpërndarjes së rezultateve, përvojat e pjesëmarrësve të rinj gjithashtu duhet t'u prezantohen të tjerëve. Secili grup pjesëmarrës mundet, për shembull, të organizojë një prezantim për mjedisin e tyre lokal, mbi mënyrën se si ata e përjetuan projektin. Mediat lokale mund të jenë gjithashtu të interesuara për të dëgjuar tregimet nga vetë pjesëmarrësit në raste të tilla. Duke ndarë përvojat e tyre në këtë mënyrë, grupi do t'i japë më shumë vlerë rezultateve të mësuarit të arritur dhe do të kontribuojë duke forcuar rëndësinë e të mësuarit jo-formal në fushën e punësimit të të rinjve.



KRITERET E PJESËMARRJES PËR MBËSHTETJE TË SHKËMBIMEVE RINORE NGA PROGRAMI ERAMUS +

Kush mund të jetë partner: Një person juridik publik ose privat (kryesisht jo-fitimprurës) që vepron në nivel lokal, rajonal, kombëtar ose Evropian ose një grup jo-formal të rinjsh.

Origjina e partnerëve: Partnerët (grupet e të rinjve pjesëmarrës) mund të vijnë nga Vendet e Programit ose nga Vendet Partnere fqinje me Bashkimin Evropian. Çdo projekt duhet të ketë të paktën një partner nga Vendet e Programit.

Numri minimal i partnerëve:

- 2 (nëse Shkëmbimi Rinor zbatohet brenda Key Action 1)
- 3 (nëse Shkëmbimi Rinor zbatohet brenda "Ngritja e kapaciteteve në fushën e rinisë" në Key Action 2)

Pjesëmarrësit: Të rinj të moshës 13 dhe 30 vjeç; minimumi 16 dhe maksimumi 60 pjesëmarrës, (këtu nuk përfshihen liderat apo punonjësit rinor) minimalisht 4 pjesëmarrës për grup, ku sërisht liderat apo punonjësit rinor nuk përfshihen. Liderat e grupeve duhet të jenë mbi 18 vjeç.

Kohëzgjatja e projektit:

- nga 3 muaj deri në 2 vjet (në qoftë se Shkëmbimi Rinor zbatohet në Key Action 1)
- nga 9 muaj deri në 2 vjet (nëse Shkëmbimi Rinor zbatohet në "Ngritja e kapaciteteve në fushën e rinisë" Key Action 2)

Kohëzgjatja e aktivitetit: Nga 5 deri në 21 ditë, duke përjashtuar kohën/ditët e udhëtimit.

Vendi i aktivitetit: Një nga shtetet e organizatave pjesëmarrëse.





AKTIVITETET VULLNETARE



Aktivitetet Vullnetare u ofrojnë të rinjve mundësinë e kryerjes së punës vullnetare afatgjatë (deri në 12 muaj) me një organizatë pranuese nga një shtet tjetër. Puna e vullnetarit synon të ndikojë në aktivitetet e përditshme të organizatës pranuese, si dhe të ketë një impakt pozitiv në komunitetin lokal. Aktivitetet e organizatës pritëse mund të trajtojnë fusha të ndryshme, siç janë avancimi social-arsimor i të rinjve dhe angazhimi qytetar, informimi i të rinjve, përfshirja e grupeve me disavantazhe, çështjet mjedisore ose zhvillimore, kultura dhe fusha artistike, etj.

Duke jetuar në një vend të huaj dhe duke zbatuar detyrat e dakorduara me organizatën pranuese, vullnetarët e Erasmus+ përfitojnë mundësi të ndryshme të të mësuarit. Vullnetarët inkurajohen të luajnë një rol aktiv në formësimin e detyrave dhe aktiviteteve të kryera përgjatë shërbimit, në përputhje me interesat e tyre për të mësuar. Të mësuarit e vullnetarëve ndikohet dhe përmirësohet nga Cikli i Trajnimit të Vullnetarizmit dhe Vlerësimit të Erasmus+, që organizohet nga Agjensitë Kombëtare (National Agencies) që financojnë projektin ose Qendrat Burimore SALTO, si dhe përmes mbështetjes personale të ofruar nga një mentor i emëruar brenda organizatës pranuese.

Aktivitete Vullnetare janë të hapura për të gjithë të rinjtë pavarësisht nga gjinia, përkatësia etnike, bindjet fetare ose

politike, orientimi seksual etj. Gjithashtu, nuk duhet të kërkohej asnjë kualifikim paraprak apo nivel arsimor i përcaktuar nga vullnetarët. Një profil specifik vullnetari mund të përcaktohet vetëm nëse konteksti i projektit e kërkon me patjetër diçka të tillë.

Çdo Aktivitet Vullnetar përfshin të paktën një organizatë dërguese dhe një organizatë pranuese, dhe gjithashtu një vullnetar. Njëra nga organizatat merr gjithashtu rolin e orgnizatës koordinuese (dhe aplikantit për të gjithë projektin). Ky rol mund të merret edhe nga një organizatë e veçantë koordinuese, veçanërisht në Projektet Vullnetare të mëdha. Nën rrethana ideale, Aktivitetet Vullnetare bazohen në partneritete afatgjata midis organizatave dërguese dhe pranuese, të cilat shpesh janë reciproke, duke ofruar mundësi të të mësuarit për të rinjtë me të cilët këto organizatat punojnë. Detyrat e secilit partner dhe të vullnetarit Erasmus+ përshkruhen në një marrëveshje ndërmjet organizatës dërguese dhe asaj pranuese.

Çdokush i përfshirë në një Aktivitet Vullnetar duhet të respektojë parimet e Kapitullit të Vullnetarizmit të Erasmus+ (Erasmus+ Volunteering Chapter), i cili përcakton të drejtat dhe detyrimet e të gjitha palëve pjesëmarrëse në projekt, kufizon punën e vullnetarëve me qëllime jo-fitimprurëse dhe ndalon përdorimin e vullnetarëve Erasmus+ për detyra të cilat sipas karakterit të tyre, duhet të kryhen nga stafi i punësuar i organizatave.

Një projekt vullnetar mund të jetë një kombinim i një ose më shumë aktiviteteve të mëposhtme:

- **Aktivitetet Vullnetare afat-gjata individuale** të cilat zgjasin nga 2 deri në 12 muaj. Të rinjtë me mundësi më të pakëta mund të vullnetarizohen jashtë shtetit të tyre për një periudhë afat-shkurtër që fillon nga 2 javë.
- **Aktivitete Vullnetare në Grup** (10-40 vullnetarë) zgjasin mes 2 javëve dhe dy muajve. Këto aktivitete mund të përfshijnë ndihmën e vullnetarevë në ndërtimin e një shtëpie, rregullimin e një parku apo organizimin e një festivali filmi, ku vullnetarët përfitojnë njohuri dhe kompetenca specifike.

AKREDITIMI I ORGANIZATAVE PJESËMARRËSE NË AKTIVITETET VULLNETARE ERASMUS+

Për të marrë pjesë në një Aktivitet Vullnetar, një organizatë duhet së pari të akreditohet. Akreditimi është një formë e njohjes se sa një organizatë është e aftë të shërbejë si organizatë koordinuese, dërguese ose pranuese. Proçesi i akreditimit fillon me një aplikim për akreditim, që organizatat mund ta dorëzojnë në çdo kohë në formë elektronike tek Agjencia Kombëtare përkatëse ose Qendra Burimore Rajonale SALTO. Në rajonin e Ballkanit Perëndimor, akreditimi bëhet nga Qendra Burimore për Evropën Juglindore (SALTO-SEE).

BAZA E TË DHËNAVE E ORGANIZATAVE TË AKREDITUARA PËR AKTIVITETET VULLNETARE

Ka disa mënyra të ndryshme për të identifikuar partnerët për Aktivitetet Vullnetare. Mënyra më e qartë është të kontrolloni Portalin Evropian të Rinisë (European Youth Portal), i cili përfshin një data bazë të dhënash të të gjithë organizatave të akredituara për të implementuar Aktivitetet Vullnetare. Në këtë portal mund të kërkonit organizatat sipas kriterëve të ndryshme, si dhe ta përdorni atë për të publikuar thirrje specifike për partnerë.

KRITERET E PJESËMARRJES PËR MBËSHTETJE NGA PROGRAMI ERASMUS +

Kush mund të jetë partner: Një person juridik publik ose privat (kryesisht jo-fitimprurës) që vepron në nivel lokal, rajonal, kombëtar ose Evropian.

Origjina e partnerëve: Partnerët (organizatat dërguese dhe pranuese) mund të vijnë nga Vendet e Programit ose nga Vendet Partnerë fqinje me BE-në. Çdo projekt duhet të ketë të paktën një partner nga një Vend i Programit.

Numri minimal i partnereve:

- 2 (nëse Aktiviteti Vullnetar zbatohet në Key Action 1)
- 3 (nëse Aktiviteti Vullnetar zbatohet në “Ngritja e kapaciteteve në fushën e rinisë” në Key Action 2)

Pjesëmarrësit: Të rinjtë e moshës 17 dhe 30 vjeç; minimumi 1 dhe maksimumi 40 pjesëmarrës për të gjithë projektin. Vullnetarët duhet të jenë banorë rezident në shtetin e organizatës së tyre dërguese.

Kohëzgjatja e projektit:

- nga 3 muaj deri në 2 vjet (nëse Aktiviteti Vullnetar implementohet brenda Key Action 1)
- nga 9 muaj deri në 2 vjet (nëse Aktiviteti Vullnetar zbatohet në “Ngritja e kapaciteteve në fushën e rinisë” në Key Action 2)

Kohëzgjatja e shërbimit:

- Aktivitetet Vullnetare individuale: nga 2 në 12 muaj. Në rast të përfshirjes së të rinjve me mundësi më të pakëta, shërbimi vullnetar mund të fillojë nga 2 javë.
- Aktivitete Vullnetare në grup: nga 2 javë në 2 muaj.

Vendi i aktivitetit: Shteti i njëres prej organizatave pjesëmarrëse, por vullnetarët Erasmus+ nuk mund të jenë nga shteti i organizatës pritëse. Një vullnetar nga një Vend i Programit duhet të kryejë aktivitetin e tij në një Vend tjetër të Programit ose në një Vend Partner fqinj me BE-në. Një vullnetar nga një Vend Partner fqinj me BE-në duhet të kryejë aktivitetin e tij në një vend të Programit.

➤ LËVIZJA E PUNONJËSVE RINOR ◀

Lëvizja e punonjësve rinor u mundëson aktorëve në fushën e rinisë, që së bashku me partnerët e tyre, të krijojnë aktivitete për punonjësit rinor dhe liderat rinor për të mbështetur zhvillimin e tyre profesional dhe fuqizuar kompetencat e tyre të të punuarit me të rinjtë. Këto aktivitete organizohen nga organizatat pjesëmarrëse në projekt. Pjesëmarrja e punonjësve rinor në aktivitete të tilla kontribuon në rritjen e kapaciteteve të organizatave të tyre dhe duhet të ketë një ndikim të qartë në punën e përditshme të punonjësve rinor me të rinjtë. Rezultatet e mësimit duhet të shpërndahen më tej në fushën e të rinjve. Aktivitetet duhet të ndjekin një qasje dhe metodologji të përshtatshme për arsim jo-formal.

Ekzistojnë dy lloje të aktiviteteve të lëvizjes për punonjësit rinor: aktivitete në grup me numër më të madh partnerësh dhe pjesëmarrësish (p.sh. seminare profesionale për tema që lidhen me punën rinore ose politikat rinore, trajnimet për punonjësit e rinisë dhe aktorë të tjerë në fushën e punës me të rinjtë, seminare për kërkimin e partnerëve të projektit dhe vizitat studimore) dhe aktivitete individuale (p.sh. vizita në vende pune në organizatat partnere (job shadowing)), të cilat zakonisht përfshijnë dy partnerë dhe një ose dy pjesëmarrës.



KRITERET E PJESËMARRJES PËR MBËSHTETJE NGA PROGRAMI ERASMUS +

Kush mund të jetë partner: Një person juridik publik ose privat (kryesisht jofitimprurës) që vepron në nivel lokal, rajonal, kombëtar ose evropian.

Origjina e partnerëve: Partnerët mund të vijnë nga Vendet e Programit ose nga Vendet Partnere fqinje me BE-në. Çdo projekt duhet të ketë të paktën një partner nga një vend i Programit.

Numri minimal i partnerëve:

- 2 (nëse Lëvizja e punonjësve rinor zbatohet brenda Key Action 1)
- 3 (nëse Lëvizja e punonjësve rinor zbatohet brenda “Ngritja e kapaciteteve në fushën e rinisë” në Key Action 2)

Pjesëmarrësit: Nuk ka kufij moshe; maksimumi 50 pjesëmarrës nga shtetet e partnerëve të projektit, duke përfshirë trajnuesit, lehtësuesit dhe stafin që kryen aktivitetet e projektit. Pjesëmarrësit duhet të jenë rezidentë në shtetin e organizatës së tyre dërguese ose pranuese.

Kohëzgjatja e projektit:

- nga 3 muaj deri në 2 vjet (nëse Lëvizja e punonjësve rinor zbatohet brenda Key Action 1)
- nga 9 muaj deri në 2 vjet (nëse Lëvizja e punonjësve rinor zbatohet brenda “Ngritja e kapaciteteve në fushën e rinisë” në Key Action 2)

Kohëzgjatja e aktivitetit të projektit:

- nga 2 ditë në 2 muaj, duke përfshirë kohën e udhëtimit. Minimumi i 2 ditëve duhet të jetë i njëpasnjëshëm (nëse Lëvizja e punonjësve rinor zbatohet brenda Key Action 1)
- nga 5 ditë në 2 muaj, duke përfshirë kohën e udhëtimit (nëse Lëvizja e punonjësve rinor zbatohet brenda “Ngritja e kapaciteteve në fushën e rinisë” në Key Action 2)

Vendi i aktivitetit: Shteti i njërit prej organizatave pjesëmarrëse..

Partneritetet Strategjike në fushën e rinisë ofrojnë mundësi për zbatimin e aktiviteteve që çojnë në profesionalizimin e përgjithshëm dhe zhvillimin e praktikave të punës me të rinjtë në Evropë. Aktivitetet mund të jenë të larmishme, duke synuar eksperimentimin ose aplikimin e metodave, mjeteve ose qasjeve inovative apo shkëmbimin e praktikave më të mira.

Në veçanti, aktivitetet mund të adresojnë nxitjen e zhvillimeve të kompetencave kyçe të të rinjve, njohjen e rezultateve të mësimi jo-formal, profesionalizimin e punonjësve rinor, modernizimin e formave të punës me të rinjtë, luftën ndaj marxhinalizimit të të rinjve në rrezik, rrjetëzimin e aktorëve dhe institucioneve të ndryshme të lidhura me rininë ose bashkëpunimin strategjik të autoriteteve publike përgjegjëse për të rinjtë.

Programi gjithashtu mbështet projektet e Partneriteteve Strategjike ndërsektoriale që synojnë të prodhonë rezultate konkrete në zhvillimin e politikave rinore ose përmirësimin e kompetencave për organizimin dhe performancën më të mirë të punës me të rinjtë. Projekte të tilla duhet të përfshijnë aktorë nga fusha të ndryshme të mbuluara nga Programi Erasmus +, duke përfshirë këtu dhe sektorin e rinisë. Partneritetet mund të përfshijnë edhe ndërmarrjet, veçanërisht kur rezultatet e dëshiruara të projektit janë të përqëndruara në rritjen e kontributit të mësimi jo-formal në punën

me të rinjtë për të rritur nivelin e punësueshmërisë së të rinjve, veçanërisht atyre me më pak mundësi.

Partneritetet Strategjike në fushën e të rinjve gjithashtu mbulojnë nismat rinore ndërkombëtare, të cilat janë aktivitete bashkëpunimi të drejtuara nga grupe të rinjsh nga vende të ndryshme, që kanë si qëllim rritjen e pjesëmarrjes dhe sipërmarrjes së të rinjve pjesëmarrës.

Si rregull i përgjithshëm, Partneritetet Strategjike synojnë bashkëpunimin ndërmjet organizatave të themeluara në Vendet e Programit. Megjithatë, organizatat nga Vendet Partnere mund të përfshihen në një Partneritet Strategjik, si partnerë, nëse pjesëmarrja e tyre sjell vlerë të shtuar në projekt. Për më shumë informacion mbi llojet e aktiviteteve të mundshme në kuadër të Partneriteteve Strategjike në fushën e të rinjve, ju lutemi këshillohuni me Guidën e Programit.

KRITERET E PJESËMARRJESPËR MBË-SHTETJE NGA PROGRAMI ERASMUS +

Kush mund të jetë partner: Çdo person juridik publik ose privat.

Origjina e partnerëve: Partnerët mund të vijnë nga Vendet e Programit. Pjesëmarrja e Vendeve Partnere është e mundur vetëm nëse pjesëmarrja e tyre sjell një vlerë të shtuar thelbësore për projektin.

Numri minimal i partnerëve: Minimumi 2 organizata nga 2 Vende të ndryshme të Programit.

Pjesëmarrësit: Nuk ka kufizime specifike.

Kohëzgjatja e projektit: Nga 6 muaj deri në 3 vjet.

Vendi i aktivitetit: Shteti i njëjës prej organizatave pjesëmarrëse.



NGRITJA E KAPACITETEVE NË FUSHËN E TË RINJVE

Projektet për ngritjet e kapaciteteve janë projekte bashkëpunimi ndërkombëtare të bazuara në partneritete shumëpalëshe midis organizatave aktive në fushën e të rinjve në Vendet e Programit dhe ato Partnere. Këto projekte gjithashtu mund të përfshijnë organizata nga fushat e arsimit dhe trajnimit, si dhe nga sektorë të tjerë socio-ekonomikë. Projektet e ngritjes së kapaciteteve financohen nën Key Action 2 të Programit dhe përfshijnë projekte në kuadër të **Dritares Rinore të Ballkanit Perëndimor**.

Termi “Dritarja Rinore e Ballkanit Perëndimor” i referohet faktit që Programit Erasmus+ i janë dhënë fonde shtesë të BE-së, me qëllim bashkëpunimin rinor me Vendet Partnere në rajonin e Ballkanit.

Projektet për ngritjen e kapaciteteve të të rinjve synojnë të përmirësojnë cilësinë dhe njohjen e punës me të rinjtë, mësimin jo-formal dhe vullnetarizmin në vendet partnere; si dhe të rrisin sinergjitë dhe të jenë plotësuese me sistemet e tjera arsimore, tregun e punës dhe shoqërinë. Ato gjithashtu duhet të nxisin zhvillimin, testimin dhe lançimin e skemave dhe programeve të reja të lëvizjes jo-formale të të mësuarit dhe praktikave të punës së të rinjve, duke rritur kompetencat e pjesëmarrësve dhe duke nxitur pjesëmarrjen e tyre aktive në shoqëri.

Projektet për ngritjen e kapaciteteve, të paraqitura nga organizatat e bazuara në

Vendet Partnere në Ballkanin Perëndimor, synojnë në veçanti rritjen e kapaciteteve të organizatave rinore përmes zbatimit të **aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve**. Përveç kësaj, ato mund të përfshijnë **aktivitete të lëvizshmërisë** (Shkëmbime Rinore, Aktivitete Vullnetare dhe Lëvizjen e punonjësve rinor).


Aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve janë të domosdoshme për çdo projekt. Ato duhet të:

- Nxisin sinergjitë dhe bashkëpunimin me autoritetet publike, fushat e arsimit dhe trajnimit dhe sektorin e biznesit;
- Të inkurajojë dialogun e politikave, bashkëpunimin, rrjetëzimin dhe shkëmbimin e praktikave;
- Zhvillojnë metoda të reja të punës me të rinjtë, materiale dhe mjete, kurrikula, module trajnimi ose instrumente të dokumentacionit;
- Krijojnë forma të reja të ofrimit të punës me të rinjtë dhe ofrimit të trajnimeve dhe mbështetjes.

Projektet për ngritjen e kapaciteteve përbëhen nga aplikuesi / koordinatori i projektit dhe partnerët, dhe mund të përfshijnë gjithashtu subjekte të anëtarësuara (affiliated entities), për shembull, organizata shtesë që kontribuojnë në arritjen e objektivave dhe aktiviteteve të projektit.

Për më shumë informacion rreth Shkëmbimeve Rinore, Aktiviteteve të Vullnetarizmit dhe Lëvizjes për punonjësit me të rinjtë, ju lutemi konsultoni [faqet 10-15](#).

Ngritja e kapaciteteve në fushën e të rinjve gjithashtu synon edhe rajonet partnere të Programit Erasmus+. Për më shumë informacion, ju lutemi konsultoni me Guidën e Programit Erasmus+.



KRITERET E PJESËMARRJES PËR MBËSHTETJE NGA PROGRAMI ERASMUS + NË DRITAREN RINORE TË BALLKANIT PERËNDIMOR

Aplikantë:

- Organizatë jo-qeveritare, shoqatë, OJF;
- Këshillat Rinor Kombëtar;
- Organ publik (i themeluar sipas ligjit publik);
- Ligjërishit i regjistruar për të paktën 1 vit nga momenti i aplikimit;
- Themeluar në një nga Vendet Partnere në Ballkanin Perëndimor.

Partnerët:

- Çdo **organizatë publike ose private** e themeluar në një Vend të Programit apo në Ballkanin Perëndimor.

Partneriteti:

- Minimalisht 3 organizata pjesëmarrëse nga **3 shtete të ndryshme**; duke përfshirë **të paktën 1 nga Vendet e Programit dhe 1 nga Ballkani Perëndimor**.

Kohëzgjatja:

- 9 muaj - 2 vjet

Aktivitetet:

- Projekti duhet me patjetër të përfshijë aktivitete të ngritjes së kapaciteteve (dhe mund të përfshijë aktivitete lëvizje shtesë).
- Një aplikant mund të aplikojë vetëm më një projekt në secilin afat aplikimesh.

Kriteret e vlerësimit:

- Rëndësia e projektit (maksimumi 20 pikë)
- Cilësia e hartimit dhe zbatimit të projektit (maksimumi 30 pikë)
- Cilësia e ekipit të projektit dhe bashkëpunimi (maksimumi 30 pikë)
- Impakti dhe shpërndarja e rezultateve (maksimumi 20 pikë)





TAKIME MES TË RINJVE DHË

VENDIM-MARRËSVE NË FUSHËN E RINISË



Takimet mes të rinjve dhe vendim-marrësve në fushën e rinisë promovojnë pjesëmarrjen e aktive të të rinjve në jetën demokratike dhe inkurajojnë debatin në temat dhe prioritetet brenda Dialogut të Strukturuar dhe/ose brenda në kuadrin e rinovuar politik në fushën e të rinjve. (Strategjia Rinore e Bashkimit Evropian 2010-2018).

Objektivi kryesor i këtyre aktiviteteve është t'ju mundësojë të rinjve të njihen me sfida të veçanta, të zhvillojnë mendimet e tyre gjatë proceseve si dhe të zhvillojnë propozimet e tyre për institucionet vendore, kombëtare apo Evropiane. Gjithashtu synojnë tu japin mundësi këtyre të rinjve që opinionet dhe propozimet e tyre t'ua prezantojnë vendim-marrësve në formën e një dialogu të arsyetuar.


Një projekt mund të përfshijë një ose disa nga aktivitetet e mëposhtme:

- Takime kombëtare dhe seminare ndërkombetare që ofrojnë hapësirë për informacion, debat dhe pjesëmarrje aktive të të rinjve në dialog me vendim-marrësit e rinj mbi çështje që janë të lidhura me Dialogun e Strukturuar ose me Strategjinë Rinore të Bashkimit Evropian;
- Takime kombëtare dhe seminare ndërkombetare që përgatisin terrenin për Konferenca Zyrtare Rinore të cilat organizohen gjatë çdo



tre-mujori nga Shteti Anëtar i cili mban Presidencën e Bashkimit Evropian;

- Evente që promovojnë debate dhe informacione mbi tematikat e politikave rinore që lidhen me aktivitetet e organizuara gjatë Javës Evropiane të Rinisë;
- Konsultime të të rinjve, me qëllim që të zbulojnë nevojat e tyre ose problemet që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen në jetën demokratike (konsultime online, votime të opinionëve, etj);
- Takime dhe seminare, evente informuese, ose debate midis të rinjve dhe vendim-marrësve/ ekspertëve të rinj rreth tematikës së pjesëmarrjes në jetën demokratike;
- Evente që simulojnë funksionimin e institucioneve demokratike dhe rolin e vendim-marrësve në këto institucione.



KRITERET E PJESËMARRJES PËR MBËSH-TETJE NGA PROGRAMI ERASMUS +

Kush mund të jetë partner: Një organizatë jo-fitimprurëse, një organizatë Evropiane Rinore ose një organ publik në nivel kombëtar ose rajonal.

Origjina e partnerëve: Partnerët mund të vijnë nga Vendet e Programit ose nga Vendet Partnere fqinje me Bashkimin Evropian. Çdo projekt duhet të ketë të paktën një partner nga Vendet e Programit.

Numri minimal i partnerëve: Një partner⁶ për takimet kombëtare dhe të paktën 2 partnerë nga vende të ndryshme për takimet ndërkombëtare.

Pjesëmarrësit: Minimumi 30 pjesëmarrës të rinj nga mosha 13-30 vjeç. Nëse projekti parashikon pjesëmarrjen e vendim-marrësve apo ekspertëve në fushën e politikave rinore ata mund të përfshihen pavarësisht nga mosha apo vendi i rezidencës.

Kohëzgjatja e projektit:

- Nga 3 muaj deri në 2 vjet.

Kohëzgjatja e aktivitetit:

- Minimalisht 1 ditë.

Vendi i aktivitetit: Takimet kombëtare duhet të bëhen në vendin e organizatës aplikuese. Takimet ndërkombëtare mund të zhvillohen në secilin nga vendet e programit që përfshihen në projekt.

⁶ Projektet e Dialogut të Strukturuar mes të rinjve dhe vendim-marrësve janë e vetmja mundësi që bashkëpunimi me partnerë nga vendet e tjera të mos ketë nevojë për mbështetje në Programin Erasmus +.




KUSH E ZBATON PROGRAMIN ERASMUS+ YOUTH IN ACTION?

Komisioni Evropian është përgjegjës për gjithë programin. Agjensia Ekzekutive e Komisionit Evropian për Edukimin, Auto-Vizualitetin dhe Kulturën është përgjegjëse për zbatimin e Aksioneve (Actions) të centralizuara të programit Erasmus+, duke përfshirë projektet e dhëna në kuadër të ngritjes së kapaciteteve (Dritaren Rinore të Ballkanit Perëndimor).

Një pjesë e madhe e programit menaxhohet në mënyrë të decentralizuar nga Agjensitë Kombëtare në secilin nga vendet e programit Erasmus+. Agjensitë Kombëtare menaxhojnë përzgjedhjet e projekteve si dhe u japin informacion përfituesve të programit dhe u japin informacion dhe mbështetje të gjithë atyre që janë të interesuar për të aplikuar për grante.

Përveç kësaj, një rrjet prej gjashtë qendrash burimore SALTO-YOUTH asistojnë Agjensitë Kombëtare dhe aktorë të tjerë në cilësinë e implementimit të programit Erasmus+: Youth in Action dhe në zhvillimin e punës me të rinjtë në nivel Evropian dhe politikave rinore. Përmes punës së tyre në fushat prioritare në fushën Rinore Evropiane, ato ofrojnë burime, informacione, trajnime dhe rrjetëzime, si dhe nxisin njohjen dhe mësimin jo-formal në punën me të rinjtë. Përveç 3 qendrave burimore SALTO tematikë; tre qendra të tjera rajonale SALTO ofrojnë mbështetje për implementimin e programit Erasmus+: Youth in Action dhe me rajonet partnere fqinje të programit, duke përfshirë rajonin e Ballkanit Perëndimor (për më shumë informacioni shikoni faqet 32-33).

Rrjeti Eurodesk ofron shërbime informacioni për të rinjtë dhe ata që punojnë me ta, në lidhje me mundësitë në fushën e arsimit, trajnimit dhe rinisë në Evropë, gjithashtu në lidhje me programin Erasmus+: Youth in Action.





SHTETET QË MUND TË MARRIN PJESË

VENDET E PROGRAMIT

- **Shtetet anëtare të BE-së:** Austri, Belgjikë, Bullgari, Kroaci, Qipro, Republika Çeke, Danimarkë, Estoni, Finlandë, Francë, Gjermani, Greqi, Hungari, Irlandë, Itali, Letoni, Lituani, Luksemburg, Maltë, Hollandë, Poloni, Portugali, Rumani, Sllovaki, Slloveni, Spanjë, Suedi dhe Mbretëria e Bashkuar.
- **Vendet të Programit jo-Evropiane :** Islanda, Lihtenshtejni, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Norvegjia dhe Turqia.

VENDET PARTNERE FQINJE NË BASHKIMIN EUROPIAN:

- **Ballkani Perëndimor (Rajoni 1):** Shqipëria, Bosnia dhe Hercegovina, Kosova⁷, Mali i Zi dhe Serbia.
- **Vendet e Partneritetit Lindor (Rajoni 2):** Armenia, Azerbajxhani, Bjellorusia, Gjeorgjia, Moldovia, Territori i Ukrainës siç njihet nga e drejta ndërkombëtare.
- **Vendet e Mesdheut Jugor (Rajoni 3):** Algjeria, Egjipti, Izraeli, Jordania, Libani, Libia, Maroku, Palestina, Siria dhe Tunizia.
- **Federata Ruse (Rajoni 4):** Territori i Rusisë siç njihet nga e drejta ndërkombëtare.

Vende të Tjera Partnerë: Vende të Tjera Partnerë në botë siç përcaktohet në Guidën e Programit.



⁷ Ky përcaktim është pa paragjyime ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe Opinionin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

PROCEDURA E APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT

Aplikimet për financim të projekteve nga programi, bëhen përmes formularëve të aplikimit elektronik me disa afate për aplikim çdo vit. Përpara aplikimit, çdo organizatë duhet të jetë e pajisur me **Kodin Identifikues të Pjesëmarrësit (Participant Identification Code-PIC)** duke krijuar një profil të organizatës në një portal specifik të Komisionit Evropian. Më shumë informacione për procedurën e aplikimit, formën e aplikimit dhe afatet, si dhe për të gjitha dokumentat e nevojshme (duke përfshirë edhe Guidën e Programit të vitit përkatës) mund t'i gjeni në uebsajtet e Agjensive Kombëtare, Agjensisë Ekzekutive për Edukim, Audio-Vizualitet dhe Kulturë (EACEA) dhe Komisionit Evropian. (Shikoni linqet përkatëse në [faqen 35](#))


Në Vendet e Programit Erasmus+, projektet dorëzohen tek Agjencia Kombëtare përkatëse e shtetit të aplikantit. Aplikimet për aksionet e centralizuara të Programit Erasmus+, duke përfshirë dhe projektet e grantuara në Dritaren Rinore të Ballkanit Perëndimor, dorëzohen tek Agjencia Ekzekutive për Edukim, Audio-Vizualitet dhe Kulturë (EACEA).

Organizatat nga Vendet Partnere në Ballkanin Perëndimor mund të

aplikojnë për projekte për ngritjen e kapaciteteve brenda Dritares Rinore të Ballkanit Perëndimor në EACEA, ose të jenë partnerë në projekte nën disa aksione të caktuara (siç janë paraqitur në faqet 10-21) të aplikuara për një Agjenci Kombëtare ose EACEA nga partneri i tyre i projektit i bazuar në një vend të programit.

Në përputhje me të gjitha kriteret e përshatshmërisë për secilin Aksion dhe/apo lloji aktiviteti, projekt propozimet vlerësohen sipas kriterëve që reflektojnë aspektet e cilësisë së projekt propozimit. Institucionet përgjegjëse për përzgjedhjen e projekteve kryejnë gjithashtu vlerësimin sipas kriterëve të përjashtimit dhe përzgjedhjes specifike, për tu siguruar që aplikanti i përmbush të gjitha rregullat financiare të Bashkimit Evropian dhe ka kapacitet të mjaftueshëm financiar për të përfunduar projektin e propozuar.

Mekanizmat e financimit që zbatohen në kuadër të programit Erasmus+, si dhe rregullat e financimit që lidhen me të gjitha aktivitetet mund ti gjeni të listuara në guidën e programit të vitit përkatës.





VEÇORI TË RËNDËSISHME TË PROGRAMIT ERASMUS+

- ★ NJOHJA DHE VLEFESHMËRIA E AFTËSIVE DHE KUALIFIKIMEVE
- ★ SHPËRNDARJA DHE PËRDORIMI I REZULTATEVE TË PROJEKTIT
- ★ AKSESI NË MATERIALE DHE DOKUMENTA EDUKATIV
- ★ DIMESIONI NDËRKOMBËTAR
- ★ SHUMËGJUHËSIA
- ★ BARAZIA DHE PËRFESHIRJA
- ★ MBROJTJA DHE SIGURIA E PJESËMARRËSVE

Programi Erasmus+ përmban karakteristika të rëndësishme të cilat janë të përshkruara më poshtë me referencë specike për bashkëpunimin me të rinjtë.

NJOHJA DHE VLEFSHMËRIA E AFTËSIVE DHE KUALIFIKIMEVE

Programi Erasmus+: Youth in Action synon të krijojë një njohje më të madhe të kompetencave dhe aftësive të fituara nëpërmjet edukimit jo-formal përmes pjesëmarrjes në forma të ndryshe të punës me të rinjtë. Për këtë qëllim Programi ofron një mjet Evropian siç është Youthpass-i i cili është një dokument i strukturuar që bën vlerësimin e kompetencave të fituara në projekt. Përveç kësaj Youthpass-i funksionon edhe si një certifikatë për rezultatet e arritura gjatë procesit të të mësuarit. Të gjithë pjesëmarrësit në një projekt të mbështetur nga programi Erasmus+: Youth in Action kanë të drejtë të marrin këtë certifikatë. Certifikatat krijojnë nga partnerët e projektit, ndërsa Agjensitë Kombëtare ofrojnë informacion dhe trajnime të ndryshme për mënyrën e krijimit të këtyre certifikatave.

SHPËRNDARJA DHE PËRDORIMI I REZULTATEVE TË PROJEKTIT

Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të projektit është një nga fazat kryesore në ciklin e jetës së një projekti në kuadër të programit Erasmus+: Youth in Action. Organizatat pjesëmarrëse inkurajohen që ti bëjnë sa më të njohura rezultatet e projektit të tyre, si p.sh: për publikun,

komunitetin lokal, organizatat e tjera apo me vendim-marrësit etj. Në këtë mënyrë rritet ndikimi i projektit të tyre dhe qëndrueshmëria e tij. Niveli dhe intensiteti i shpërndarjes dhe publikimit të të dhënave duhet të jetë proporcional me qëllimin e projektit dhe objektivat e tij.

AKSESI NË MATERIALE DHE DOKUMENTA EDUKATIV

Programi Erasmus+: Youth in Action promovon akses të hapur në materiale dhe broshura të prodhuara si pjesë e projektit dhe që janë të dobishme në punën me të rinjtë. Organizatorët e projektit duhet të promovojnë aksesueshmërinë e tyre duke i bërë ato lirisht të disponueshme (në internet). Megjithatë janë ata vetë që mund të përcaktojnë nivelin më të përshtatshëm të aksesit. Kërkesa për akses të hapur nuk çënon të drejtat e pronësisë intelektuale të përfituesve të grantit.

DIMESIONI NDËRKOMBËTAR

Programi Erasmus+: Youth in Action përfshin një dimension të fortë ndërkombëtar, i cili demonstron nga mundësia e bashkëpunimit me vendet partnere në të gjitha Key Actions të programit. Megjithatë, në disa raste pjesëmarrja e tyre duhet të ofrojë një vlerë të shtuar për projektin.

Lidhur me Ballkanin Perëndimor, Programi Erasmus+: Youth in Action kontribuon në nxitjen e stabilitetit në rajon duke mbështetur zhvillimin e punës me të rinjtë; si dhe duke promovuar multi-kulturalizmin, tolerancën dhe solidaritetin midis tyre. Në këtë mënyrë kontribuon edhe në përpjekjet e Bashkimit Evropian drejt stabilizimit të rajonit të Ballkanit Perëndimor, si dhe bashkëpunimin midis vendeve të këtij rajoni.

SHUMËGJUHËSIA

Promovimi i mësimit të gjuhës dhe diversiteti gjuhësor është theksuar në Program, pasi mungesa e kompetencave gjuhësore është një nga pengesat kryesore për të mësuarit në lëvizjen ndërkombëtare. Mbështetja për mësimin e gjuhëve është e mundur për pjesëmarrësit që përfshihen në aktivitete me kohë të gjatë, siç janë Aktivitetet Vullnetare. Një mjet

për mësimin e gjuhëve kryesore Evropiane në internet ofrohet nga Erasmus+ Online Linguistic Support e cila përfshin një vlerësim të detyrueshëm të kurseve gjuhësore si dhe kurse gjuhe vullnetare.

BARAZIA DHE PËRFSHIRJA

Programi Erasmus+: Youth in Action është i hapur për TË GJITHË të rinjtë, përfshirë këtu edhe të rinjtë me më pak mundësi. Programi synon ti inkurajojë ata të përdorin mundësitë që ofrohen për të forcuar aftësitë dhe kompetencat e tyre përmes mësimit jo-formal dhe për të ngritur zërin e tyre në formimin dhe zhvillimin e politikave rinore në nivel lokal, kombëtar dhe Evropian.

Përkufizimi i të rinjve me më pak mundësi mund të jetë mjaft i gjerë, por grupi përfshin të rinjtë me arsim të papërfunduar apo nivel shumë të ulët të tij; gjë e cila i lë ata jashtë tregut të punës ata me kushte të vështira sociale dhe ekonomike dhe ata që janë duke u ballafaquar me pengesa të mëdha në integrimin e tyre në shoqëri për shkak të prejdardhjes së tyre kulturore, rrethanave personale ose përballjes me kufizime të tjera të ngjashme.

Për të lehtësuar përfshirjen e të rinjve me më pak mundësi ose me nevoja të veçanta, programi ofron


mundësinë të mbulojë 100% të kostove të pranueshme dhe përfshin kosto shtesë sipas nevojave specifike, pa të cilat do të ishte e vështirë ose e pamundur për këta të rinj që të merrnin pjesë në një projekt.

MBROJTJA DHE SIGURIA E PJESËMARRËSVE

Mbrojtja dhe siguria e pjesëmarrësve të përfshirë në Projektet Erasmus+ : Youth in Action janë parime të rëndësishme të programit. Secili pjesëmarrës duhet të jetë në gjendje të marrë avantazhet e plota të mundësive për zhvillim personal dhe profesional. Kjo mund të sigurohet vetëm në një mjedis të sigurt që respekton dhe mbron të drejtat e të gjithëve.

Për këtë qëllim çdo organizatë pjesëmarrëse duhet të ndërmarrë angazhime efektive për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e pjesëmarrësve në projektin e tyre. Në këtë drejtim, të gjithë pjesëmarrësit e përfshirë në Key Action 1 dhe 2 të programit duhet të jenë të pajisur me siguracion që mbulon risqet e lidhura me pjesëmarrjen e tyre në projekt; ndërsa projektet vullnetare përfshijnë një politikë specifike siguracioni që është pjesë integrale e projektit.

Organizatrat që përfshijnë të rinj nën moshën 18 vjeç duhet të marrin një autorizim paraprak nga prindërit e pjesëmarrësve ose ata që veprojnë në emër të tyre.



MBËSHTETJA E OFRUAR NGA QENDRA BURIMORE PËR EVROPËN JUG-LINDORE SALTO, PËR PJESËMARRJEN E BALLKANIT PERËNDIMOR NË PROGRAMIN ERASMUS+ YOUTH IN ACTION

Qendra Burimore për Evropën Juglindore SALTO (SALTO SEE) është një nga gjashtë Qëndrat Burimore SALTO-YOUTH. Akronimi SALTO YOUTH qëndron për “Mbështetje dhe Mundësi të të Mësuarit dhe Trajnimit të Avancuar” (Support, Advanced Learning and Training Opportunities) në Programin Erasmus+ Youth in Action. Është themeluar në vitin 2000 dhe është një rrjet i qendrave burimore që punojnë në tematikat prioritare Evropiane në fushën e rinisë.

Si pjesë e Strategjisë së Trajnimit të Komisionit Evropian, SALTO-YOUTH ofron burime jo-formale të të mësuarit për punonjësit e rinj dhe liderat e rinj, gjithashtu organizon trajnime dhe aktivitete për vendosjen e kontakteve për të mbështetur organizatat dhe Agjensitë Kombëtare në kuadër të programit Erasmus+: Youth in Action dhe më gjerë. Në këtë mënyrë këto target grupe forcojnë më shumë kompetencat e tyre në punën me të rinjtë duke përdorur metodologjinë e edukimit jo-formal, si dhe duke mbështetur pjesëmarrjen e të rinjve në zhvillimin e politikave rinore në nivele të ndryshme.

Qendra Burimore e Evropës Juglindore SALTO, promovon dhe mbështet pjesëmarrjen e të rinjve në metodologjinë e edukimit jo-formal nga vendet partnere të programit të Ballkanit Perëndimor në programin Erasmus+: Rinia në Veprim dhe ka për qëllim që të kontribuojë në punën e të rinjve dhe zhvillimin e politikave rinore në Ballkanin Perëndimor. Ajo vepron si një shërbim mbështetës për:

- Rrjetin e programit Erasmus+ Youth in Action si dhe Agjensitë Kombëtare të rajonit dhe
- organizata rinore, liderat e rinj, punonjësit me të rinjtë dhe aktorët e tjerë që janë të intersuar për të bashkëpunuar ndërmjet vendeve të programit dhe vendeve fqinje të rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Në kuadër të integritimit Evropian të rajonit të Ballkanit, Qendra Burimore SALTO SEE mbështet në mënyre aktive procesin e aderimit të të gjitha vendeve të rajonit në Programin Erasmus+: Youth in Action. Programi i aktiviteteve të qendrës udhëhiqet me mbështetjen e grupeve të trajnerëve dhe akredituesve, veçanërisht në kuadër të aktiviteteve vullnetare të Erasmus +, si dhe pikave të kontaktit për Erasmus +: Rinia në Veprim, të vendosura në Vendet Partnerë të Programit në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

SALTO SEE kryen akreditimet për aktivitetet vullnetare të organizatave që veprojnë në vendet partnere të Ballkanit Perëndimor dhe organizon ciklin e trajnimeve dhe vlerësimeve Erasmus+ për vullnetarët që kryejnë vullnetarizmin në rajon apo nga rajoni në BE.

Më shumë informacion rreth aktiviteteve mbështetëse të hapura për pjesëmarrësit nga rajoni i Ballkanit Perëndimor e gjeni në faqet e internetit të SALTO SEE dhe në Kalendarin Evropian të Trajnimit (shih linqet në [faqen 35](#)).

PIKAT E KONTAKTIT NË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR

Në mënyrë që të sjellim njohuri dhe burime për përfituesit e mundshëm të programit Erasmus+: Youth in Action, SALTO SEE ka emëruar Pikat e Kontaktit për Programin në secilin vend partner të Ballkanit Perëndimor. Pikat e Kontaktit janë organizata rinore me përvojë në program dhe me kapacitet për ta transferuar këtë njohuri më tej tek të tjerët. Detyra e tyre është të promovojnë Programin, si dhe të ofrojnë informacion, këshilla dhe trajnime në nivel kombëtar..

PIKAT E KONTAKTIT NË SHQIPËRI
Organizata Përtej Barrierave është një organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurese që mbron të drejtat dhe interesat e të rinjve. Misioni i saj

është të promovojë mundësi të barabarta për të gjithë të rinjtë dhe veçanërisht për të rinjtë me disavantazhe sociale, duke u ofruar atyre mbështetje për tu fuqizuar dhe marrë pjesë aktive në jetën e komunitetit. PB është Pikë Kontakti për Erasmus+ Youth in Action në Shqipëri dhe si e tillë ofron mbështetje me informacion, trajnim dhe fushata promovuese për programin, drejtuar të gjithë organizatave, institucione dhe të rinjve të interesuar. PB është e vendosur në Tiranë, por zhvillon veprimtarinë e saj në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe Evropian. PB është organizatatë e akredituar në rolet Koordinuese, Dërguese dhe Pritëse nën Aktivitetet Vullnetare Erasmus+.

Person Kontakti: Ana Mullanji – Drejtoreshë Ekzekutive
Adresa: Rruga Don Bosko, Blloku Edil-AI tek Vizion+, Kulla 4, Kati 8, Ap 52, Tirane Shqiperi
Mail: office@beyondbarriers.org
Tel: +35544806136
Web: www.beyondbarriers.org/new

Qendra për Progres Rinor (QPR) është një organizatë lokale me veprimtari në Kukës, e cila ka në fokus të rinjtë, advokon për politika efektive rinore në nivel vendor, përfshirjen e të rinjve në zhvillimin e politikave lokale dhe qeverisjen e mirë; të drejtat e njeriut dhe përfshirja sociale; zhvillimin e lidërshpit; programe vullnetare dhe aktivizëm rinor në partneritet lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. QPR u ofron të rinjve mundësinë për të kontribuar në komunitetet e tyre duke zhvilluar kapacitetet e tyre për të qenë qytetarë të angazhuar. Ne mbështesim dhe ndihmojmë të rinjtë për të fituar aftësitë sociale, vlerat, kompetencat dhe qëndrimet që do t'u lejojnë atyre që të jenë qytetar aktiv.

Person kontakti: Rifat Demalija
Adresa: L 4, Godina Kryqit Kuq, kati II-të, Kukës, Shqipëri
Mail: orgcyp@hotmail.com
Tel: +355 674777423
Web: www.cyp.al



MË SHUMË INFORMACION

Ky botim është bërë me mbështetjen e Komisionit Evropian dhe të Zyrës së Republikës së Sllovenisë për Rininë. Përmbajtja e botimit është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Komisionit Evropian.

Gendra Burimore e Ballkanit Perëndimor SALTO:

- www.salto-youth.net/see
- Email: see@salto-youth.net

Pikat e Kontaktit të Programit Erasmus+: Youth in Action në vendet e Ballkanit Perëndimor:

- <https://www.salto-youth.net/rc/see/contactpoints/>

Gendrat Burimore SALTO-YOUTH:

- <https://www.salto-youth.net/>

Kalendari Evropian i Trajnimit:

- <https://www.salto-youth.net/tools/european-training-calendar/>

Aktivitetet mbështetëse për pjesëmarrësit nga Ballkani Perëndimor:

- www.salto-youth.net/rc/see/activities

Komisioni Evropian, faqja e Rinisë:

- http://ec.europa.eu/youth/index_en.htm

Guida e Programit Erasmus+:

- http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/programme-guide_en

Agjensia Ekzekutive për Edukim, Audio Vizualitet dhe Kulturë, (Key Action 2, Capacity- building in the field of youth):

- https://eacea.ec.europa.eu/erasmus-plus/actions/cooperation-for-innovation-and-exchange-good-practices_en, E-mail: eacea-youth@ec.europa.eu

Portali Rinor Evropian:

- https://europa.eu/youth/EU_en

Platforma e rezultateve të programit Erasmus+ e Komisionit Evropian:

- <http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/projects/eplu-project-details/>

Agjensitë Kombëtare të Erasmus+:

- http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/contact_en

Rrjeti Eurodesk:

- <https://eurodesk.eu/>

Youthpass:

- <https://www.youthpass.eu/en/>

Strategjia Rinore Evropiane:

- http://ec.europa.eu/youth/policy/youth_strategy/index_en.htm

Negociatat Evropiane të Politikave të Fqinjësisë dhe Zgjerimit:

- https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/neighbourhood/overview_en

FUND

Titulli:

Erasmus+: Youth in Action:
Mundësitë për rajonin e Ballkanit
Perëndimor.

Shkruar dhe publikuar nga:

SALTO-YOUTH South East Europe
Resource Centre
MOVIT

Dunajska cesta 5
1000 Ljubljana, Slovenia
Tel.: +386 1 430 47 47
www.salto-youth.net/see
see@salto-youth.net/see

Drejtor i publikimit:

Janez Škulj

Dizenjimi nga:

AIKO, Maja Cerjak s.p.

Përkthimi dhe përshtatja në Shqip:

Irena Topalli

Bazuar në publikimin “Erasmus+:
Mladi v Akciji”, MOVIT, 2014,
përkthyer nga ALAM Aleš Lampe
s.p.; korigjuar nga: AdriatIQa,
Ljubljana, Slovenia

Edicioni i parë u publikua në
Ljubljanë në 2016; I dyti dhe i
rishikuari në 2018.



SALTO-YOUTH
SOUTH EAST EUROPE
RESOURCE CENTRE



Erasmus+



REPUBLIKA SLOVENIJA
MINISTRSTVO ZA IZOBRAŽEVANJE,
ZNANOST IN ŠPORT

URAD REPUBLIKE SLOVENIJE ZA MLADINO